

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	1 / 15

PJESA 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore synon të përcaktojë masat disiplinore, llojin dhe organin përgjegjës për dhënien e tyre, në rast mos përmbushjeje nga ana e studentëve të detyrave të ngarkuara nga ligji, statuti, rregullorja dhe udhëzimet brenda Kolegjit Universitar “Bedër” si dhe të përcaktojë mënyrën e zbatimit në praktikë të parimeve, normave dhe kërkesave në fushën e disiplinës, në funksion të respektimit të drejtave të njeriut dhe zbatimit të dispozitave ligjore.

Neni 2

Fusha e veprimit

Kjo Rregullore parashikon dhe përcakton rregullat disiplinore që duhet të zbatohen nga studentët e Kolegjit Universitar “Bedër”, shkeljet disiplinore, masat ndëshkuese, hetimin disiplinor, ankimimin dhe metodat e procedurat e ankimimit.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo Rregullore bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin për Arsimin e Lartë, vendimet e udhëzimet e dala nga MASR si dhe Statutin e Institucionit.

Neni 4

Përkufizime

Në kuptim të kësaj Rregulloreje, përveç rasteve kur përcaktohet shprehimisht ndryshe në nene të veçanta të saj, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

Njësitë e Kolegjit Universitar “Bedër”: Fakultetet, Departamentet si dhe Qendrat Kërkimore-Zhvillimore etj.

Student: Çdo person i cili studion në Kolegjin Universitar “Bedër” : **Vërejtje:** Studenti njoftohet me shkrim se i është bërë vërejtje për shkak të sjelljes jo-etike të tij.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	2 / 15

Paralajmërim me shkrim: Njoftimi i studentit me shkrim se është paralajmëruar për shkak të sjelljes jo-etike të tij dhe se duhet të ketë më shumë kujdes në lidhje me sjelljet dhe veprimet e tij.

Largim për një periudhë të shkurtër kohore nga Kolegji Universitar “Bedër”: Nënkupton ndalimin e studentit për një periudhë të shkurtër kohore për të hyrë në godinën, oborrin, ambientet sekondare apo objektet e Institucioni.

Largim për një semestër nga Kolegji Universitar “Bedër”: Nënkupton ndalimin e studentit për një semestër për të hyrë në godinën, oborrin, ambientet sekondare apo objektet e Shkollës së Lartë.

Përrjashtim nga Kolegji Universitar “Bedër”: Njoftimi i studentit me shkrim se është përjashtuar për të mos u pranuar më nga institucioni.

PJESA 2

SHKELJET DISIPLINORE DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 5

Masat disiplinore

Masat disiplinore janë si më poshtë:

- Vërejtje: I drejtohet studentit me shkresë ose në mënyrë verbale dhe i kërkohet atij të kryej detyrat e tij si student për shkak të sjelljes jo-etike të tij.
- Paralajmërim me shkrim i drejtohet studentit me shkresë dhe i kërkohet atij të tregohet më i kujdesshëm në realizimin e detyrimeve të tij si student si dhe të korrigjojë sjelljet e tij.
- Pezullim i së drejtës për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Bedër” për një periudhë kohore një javë deri në një muaj: I hiqet e drejta studentit për të përfituar nga të drejtat e tij si student i Institucioni për një periudhë kohore nga një javë deri në një muaj. Pezullimi bëhet me shkresë ose në mënyrë verbale.
- Pezullim i së drejtës për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Bedër” për një periudhë kohore një semestriale: I hiqet e drejta studentit për të përfituar nga të drejtat e tij si student i institucionit për një periudhë kohore një semestriale. Pezullimi bëhet me shkresë ose në mënyrë verbale.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	3 / 15

- e. Përrjashtimi nga Kolegji Universitar “Bedër”: Studenti përjashtohet nga institucioni dhe humbet të drejtën për tu kthyer sërish aty. Përrjashtimi bëhet me shkresë ose në mënyrë verbale.

Neni 6

Masa disiplinore vërejtje

Masa disiplinore “vërejtje” jepet në rast vërtetimi të veprimeve dhe kushteve të mëposhtme:

- Në rastet kur pa shkaqe të arsyeshme studenti nuk i përgjigjet në kohe pyetjeve që i drejtohen nga organet kompetente të institucionit,
- Të vendos njoftime jashtë vendeve të autorizuara nga organet kompetente të institucionit,
- Heqja, grisja, ndotja, ndryshimi apo shkarravitja e njoftimeve, programeve apo materialeve të vendosura me lejen e Institucioni,
- Të sillesh keq dhe në mënyrë të paedukatë kundrejt organeve kompetente të Institucioni ose kundrejt organeve kompetente të institucioneve vartëse të institucionit,
- Shpërndarja pa autorizim në ambientet e institucionit e njoftimeve, afisheve dhe të vendosë pankarta.

Neni 7

Masa disiplinore paralajmërim me shkrim

Masa disiplinore “paralajmërim me shkrim” jepet në rast vërtetimi të veprimeve dhe kushteve të mëposhtme:

- Të fsheh informacione, të japë informata të rreme ose të mangëta në rast se i kërkohet informacion nga organet kompetente të institucionit,
- Prishja e rendit në leksion, seminar, praktikë, mbledhje shkencore dhe në konferenca,
- Heqja, grisja, ndotja, ndryshimi apo shkarravitja e njoftimeve, programeve apo materialeve të vendosura nga organet kompetente të institucionit,
- Tentativë për të kopjuar në provime,

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	4 / 15

- e. Pjesëmarrja në gjendje të dehur në mësim, seminare, konferenca dhe aktivitete kërkimore.

Neni 8

Masa disiplinore pezullim i së drejtës për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Bedër” për një periudhë kohore një javë deri në një muaj

Masa disiplinore pezullim i së drejtës për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Bedër” për një periudhë kohore një javë deri në një muaj jepet në rast vërtetimi të veprimeve dhe kushteve të mëposhtme:

- a. Sjellje të cilat kufizojnë lirinë e nxënies dhe të mësimdhënies,
- b. Pengimi i mbarëvajtjes së ekzekutimit të procesit hetimor për shkeljet disiplinore,
- c. Ti japë dikujt tjetër për përdorim një dokument vetjak të dhënë nga Kolegji Universitar “Bedër” ose të përdori një dokument të dikujt tjetër të marrë nga i njëjti institucion,
- d. Të kryejë në mënyrë verbale apo të shkruar veprime që dëmtojnë nderin dhe dinjitetin e personave në institucionin e arsimit të lartë,
- e. Të kapesh duke kopjuar apo duke u dhënë kopje studentëve të tjerë, si dhe në atë lëndë cilësohen të mbetur automatikisht,
- f. Të kryejë në mënyrë verbale apo të shkruar, brenda apo jashtë Institucioni veprime që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personelit të institucionit,
- g. Përdorimi i produkteve të duhanit dhe lëndëve që shkaktojnë vartësi fizike brenda ambienteve të institucionit,
- h. Të organizojë mbledhje pa autorizim në ambiente të mbyllura apo të hapura që i përkasin institucionit,
- i. Të abuzojë duke bërë plagjiaturë të temës dhe publikimeve të nxjerra në emër të institucionit tonë.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	5 / 15

Neni 9

Masa disiplinore pezullim i së drejtës për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Bedër” për një periudhë kohore një semestriale

Masa disiplinore pezullim i së drejtës për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Bedër” për një periudhë një semestriale jepet në rast vërtetimi të veprimeve dhe kushteve të mëposhtme:

- a. Kërcënimi në mënyrë direkte ose indirekte i personelit apo studentëve të Institucioni,
- b. Cënimi dhe pengimi i veprimtarisë së institucionit me anë të uzurpimit dhe veprimeve të ngjashme të ambienteve të Institucioni,
- c. Ushtrimi i veprimeve të rënda fizike kundrejt personelit apo studentëve të institucionit,
- d. Përdorimi i pijeve alkolike dhe psikotropeve brenda ambienteve të institucionit,
- e. Të kryejë vjedhje brenda ambienteve të Institucionit,
- f. Të shkatërroj asetet, sende dhe materiale të ngjashme me to brenda godinës së Institucionit,
- g. Kopjimi në provime duke përdorur kërcënimin, bërja pengesë për të nxjerrë studentin që kopjon nga auditori, hyrja në emër të një tjetri në provim ose futja e tjetrit në emrin tënd në provim,
- h. Nxitja ose pjesëmarrja në aktivitetet që synojnë diskriminimin për shkak të gjuhës, racës, fesë dhe gjinisë,
- i. Kryerja e veprave që dëmtojnë dhe njollosin reputacionin dhe emrin e Institucionit (Nën ndikimin e lëndëve narkotike apo pijeve alkolike duke u shkaktuar dëme personave ose shoqërisë të prishësh rendin publik) dhe si rezultat i kësaj sjellje ngjarja t’u kalojë forcave të rendit,
- j. Ngacmimi seksual në mënyrë verbale brenda ambienteve të institucionit,
- k. Mbajtja e armëve, thikave, substancave eksplozive dhe instrumenteve të tjera të dizajnuara posaçërisht për të sulmuar ose për tu mbrojtur në ambientet e institucionit ose dhe dënimi për këto shkelje mbi bazën e neneve përkatëse të Kodit Penal mbi armëmbajtjen pa leje.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	6 / 15

Neni 10

Masa disiplinore përjashtim nga Kolegji Universitar “Bedër”

Masa disiplinore përjashtim nga Kolegji Universitar “Bedër” jepet në rast vërtetimi të veprimeve dhe kushteve të mëposhtme:

- a. Formim organizate me qëllim kryerje veprash penale, të drejtoj një organizatë të tillë ose të anëtarësohet në një organizatë të formuar me këtë qëllim, ose pa qenë anëtar i organizatës të kryejë veprimtari ose të ndihmojë në emër të organizatës me kusht që të ketë vendim të formës së prerë nga Gjykata përkatëse,
- b. Përdorimi, mbajtja, gjetja ose tregtimi i lëndëve narkotike brenda ambienteve të Institucionit,
- c. Përdorimi i armëve, thikave, substancave eksplozive dhe instrumenteve të tjera të dizajnuara posaçërisht për të sulmuar ose për tu mbrojtur, në ambientet e institucionit ose dhe dënimi për këto shkelje mbi bazën e neneve përkatëse të Kodit Penal mbi armëmbajtjen pa leje,
- d. Kryerja e veprime seksuale kundrejt individëve tjerë dhe si rrjedhojë të çënojë paprekshmërinë seksuale të individëve,
- e. Cënimi i lirisë, qetësisë dhe mësimdhënies në institucion për qëllime ideologjike e politike, si dhe veprime të tilla si: bojkotimi, pengimi, ngadalësimi i punës së personelit dhe pjesëmarrja në veprime të ngjashme dhe provokimi i aktiviteteve të tilla me të njëjtat qëllime,
- f. Të jesh dënuar për vepër penale të çdo lloji nga Gjykata me vendim të formës së prerë.
- g. Përfitimi i interesave të padrejta për vete ose për të tjerët duke hyrë në sistemin e informacionit të institucionit,
- h. Të pengojë punonjësit e Kolegjit Universitar “Bedër” që të ushtrojnë detyrat e tyre duke ushtruar forcë dhe dhunë ndaj tyre.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	7 / 15

Neni 11

Shkeljet disiplinore të paparashikuara

Masat disiplinore të parashikuara më sipër, të cilat jepen për veprime dhe në kushte të caktuara mund të jepen edhe për shkelje të tjera të së njëjtës rëndësi dhe të njëjtave karakteristika.

Neni 12

Përsëritja e shkeljeve disiplinore

Në qoftë se veprimi ose kushtet për të cilat është dhënë një masë disiplinore përsëritet gjatë periudhës studentore atëherë jepet masa disiplinore një shkallë më e rëndë.

PJESA E TRETË

HETIMI DISIPLINOR

Neni 13

Këshilli i Etikës dhe hetimi disiplinor

Anëtarët e Këshillit të Etikës zgjidhen nga Senati i institucionit, për një periudhë katërvjeçare.

Hetimi disiplinor bëhet nga anëtarë të përzgjedhur nga Këshilli i Etikës.

Neni 14

Procedura e fillimit të hetimit disiplinor dhe afatet e hetimit disiplinor

Hetimi disiplinor fillon me një kërkesë ankimi drejtuar administratorit të Fakultetit përkatës. administratorit i Fakultetit ia dërgon këtë kërkesë ankimi Dekanit të Fakultetit përkatës. Dekani i Fakultetit ia përcjell ngjarjen Këshillit të Etikës. Hetimi disiplinor fillon menjëherë në ditën e vënies në dijeni për veprime që bien në kundërshtim me këtë Rregullore. Hetimi disiplinor duhet të përfundojë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e fillimit të hetimeve. Nëse procesi disiplinor nuk mund të përfundojë atëherë Këshilli i Etikës në rast se e çmon të arsyeshme mund të zgjasë periudhën e hetimit disiplinor, por jo më shumë se 15 ditë mbi afatin e përcaktuar.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”			
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit
BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	8 / 15

Neni 15

Mënyra e zhvillimit të hetimit

Këshilli i Etikës dëgjon dëshmitarët, mund të kryejë një studim ose të konsultohet me një ekspert nëse është e nevojshme. Çdo hetim dhe procedurë vërtetohet me anë të një procesverbal. Në procesverbal përshkruhet: Vendi ku mbahet raporti, koha, qëllimi, kush merr pjesë, pyetjet dhe përgjigjet, dhe në përfundim firmoset nga ai që zhvillon hetimin, personi që pyetet dhe çdo i pranishëm. Në këtë procesverbal pasqyrohen dhe identiteti i dëshmitarëve, adresa dhe informacione të ngjashme. Personeli i Kolegjit Universitar “Bedër” është i detyruar ti dorëzojë Këshilli të Etikës çdo dokument, dosje ose dëshmi, pa krijuar vonesa dhe t’u ofrojnë atyre çdo ndihmesë të kërkuar.

Neni 16

E drejta e mbrojtjes

a- Studenti ndaj të cilit do të fillohet një procedurë disiplinore, duhet të njoftohet me shkresë të paktën tre ditë para fillimit të procedurës. Në këtë shkresë pasqyrohet dita, ora dhe vendi ku do të zhvillohet procedura dhe i lihet kohë në mënyrë që të përgatisë mbrojtjen e tij.

Në ato raste kur nuk është e mundur njoftimi me një shkresë zyrtare, njoftimi varet në vende të posaçme brenda Institucionit, me qëllim që dhe në këtë rast të garantohet mbrojtja.

b- Në shkresën e njoftimit dërguar studentit, duhet të pasqyrohet qartë se në rast se pa shkaqe të arsyeshme nuk paraqitet gjatë procedimit do të quhet sikur ai ka hequr dorë nga e drejta e mbrojtjes dhe në rast se për shkaqe të arsyeshme ose të forcës madhore nuk mund të paraqitet atij i akordohet një kohë shtesë për të paraqitur mbrojtjen e tij.

c- Në çdo njoftim zyrtar zbatohen nenet 35 dhe 37 të kësaj Rregulloreje.

d- Hetimi; studentit i jepet mundësia që ai të mbrojë veten. Por mbrojtja nuk mund të përdoret si shkak për të zgjatur afatet e hetimit.

Neni 17

Raporti i hetimit

Në përfundim të hetimeve hartohet një raport. Raporti pasqyron: miratimin paraprak të hetimit, datën e fillimit të hetimit, identitetin e personit të hetuar, shkelja, fazat e hetimit dhe

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	9 / 15

mbrojta. Çdo shkelje diskutohet veçmas me studentin dhe i bëhet e ditur masa disiplinore që do të zbatohet. Nëse ka dokumente të cilat kanë lidhje me çështjen ato i bashkëngjiten raportit.

Neni 18

Masat gjatë hetimit disiplinor

Këshilli i Etikës, nëse e shikon të nevojshme mund ti heqë studentit të akuzuar të drejtën për të hyrë në godinat e Institucionit. Në këtë rast zbatohet vendimi i Këshillit të Etikës.

Në rast se pas kryerjes së shkeljes disiplinore studenti ndryshon departamentin brenda Kolegjit Universitar “Bedër” ose largohet për çdo lloj arsyeje nga Kolegji Universitar “Bedër” ai do të vazhdojë të mbetet subjekt i procedimit disiplinor deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Neni 19

Aplikimi në të njëjtën kohë i hetimit penal dhe atij disiplinor

Në rast se studenti për të njëjtin veprim është në ndjekje penale, kjo e fundit nuk pengon zhvillimin në të njëjtën kohë edhe të procedimit disiplinor. Në përfundim studenti mund të jetë subjekt edhe i dënimit disiplinor dhe të atij penal.

Neni 20

Përfundimi i hetimit

a- Raporti i hetimeve dhe dosja pas shqyrtimit dhe vlerësimit si të rregullta ato i dorëzohen menjëherë Këshillit të Etikës. Këshilli i Etikës shqyrton çështjen jo më vonë se tre ditë.

b- Nëse pas shqyrtimit të dosjes Këshilli i Etikës shikon të arsyeshme marrjen e informacioneve të mëtejshme ai mund të kërkojë plotësimin e hetimeve nga një anëtar tjetër i Këshillit të Etikës.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”			
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit
BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	10 / 15

Neni 21

Organi kompetent për dhënien e masës disiplinore

Organi kompetent për dhënien e masës disiplinore është Këshilli i Etikës.

Neni 22

Mbledhja e Këshillit të Etikës

Këshilli i Etikës mbledhet mbi bazën e kërkesës së kryetarit të tij, në vendin, ditën dhe kohën e caktuar prej tij.

Neni 23

Përgatitja e punës së këshillit

Plani i mbledhjes, njoftimet, mbarëvajtja e punëve në këshill janë në kompetencë të kryetarit të tij.

Neni 24

Kuorumi në mbledhje

Mbledhja e këshillit është e vlefshme, kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Neni 25

Raportimi

Kryetari i këshillit emëron një nga anëtarët në statusin e raportuesit. Anëtari raportues, shqyrton dosjen dhe e plotëson atë brenda dy ditëve dhe më pas raportin e përgatitur ia paraqet kryetarit të këshillit.

Neni 26

Procedura e mbledhjes

Në këshill: pasi dëgjohet raportuesi kalohet në shqyrtimin e çështjes. Pasi zbardhet çështja dhe kur arrihet në mendimin se arsyetimet dhe negociatat mjaftojnë kalohet në votim dhe rezultati i votimit deklarohet nga kryetari i këshillit.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	11/15

Neni 27

Votimi

Çdo anëtar i Këshilli të Etikës ka detyrimin të japë votën e tij pro ose kundra. Abstenimi nuk lejohet. Vendimet në Këshillin e Etikës merren me shumicë të thjeshtë të të pranishmëve në mbledhje. Në rast se kemi vota të barabarta, vota e kryetarit të këshillit është vendimtare. Rezultati i votimit pasqyrohet në një procesverbal dhe nënshkruhet nga të pranishmit.

Neni 28

Vendimi

Këshilli i Etikës: ka të drejtën të japë ose jo masën e propozuar në raportin e hetimit, duke zbatuar rregullat, kushtet dhe duke parashtruar arsyet mund të japë një masë disiplinore të ndryshme.

Neni 29

Afati i dhënies së vendimit

Këshilli i Etikës për masat disiplinore vërejtje, paralajmërim me shkrim, pezullim i së drejtës për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Bedër” për një periudhë një javë deri në një muaj është i detyruar të marrë një vendim brenda pesë ditëve nga përfundimi i marrjes në pyetje.

Në ato raste kur është e nevojshme dhënia e masave të tjera disiplinore, dosja i dorëzohet menjëherë Këshillit të Etikës. Këshilli i Etikës është i detyruar të marrë një vendim brenda dhjetë ditësh nga marrja në dorëzim e dosjes nga anëtarët e Këshillit të Etikës.

Neni 30

Pikat që duhen patur parasysh gjatë dhënies së masës disiplinore

a- Këshilli i Etikës: Gjatë cilësimit dhe vlerësimit të masës disiplinore, duhet të mbajë parasysh rëndësinë e shkëljes, qëllimet dhe motivet që ka patur personi i akuzuar, nëse është përsëritës, sjellja, qëndrimi ndaj veprimit të kryer dhe pendimi.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	12 / 15

b- Në rast se ka kryer shkelje në dëm të Kolegjit Universitar “Bedër” në bashkëpunim me një student të një institucioni tjetër, jepet një masë disiplinore e një shkalle më të lartë se ajo e parashikuar për shkeljen në fjalë.

c- Për shkeljet disiplinore të kryera në bashkëpunim, kur fajtori nuk shlyen fajin, çdo personi i jepet masa që shihet e arsyeshme nga Këshilli i Etikës.

PJESA E KATËRT

ZBATIMI DHE ANKIMI

Neni 31

Njoftimi dhe zbatimi i masës disiplinore

Masa e dhënë në fund të procedurës disiplinore bëhet e ditur nga Këshilli i Etikës:

- a- Studentit ndaj të cilit është marrë një masë disiplinore,
- b- Nënës ose babait të tij, dhe në mungesë të këtyre të fundit çdo personi të afërm,
- c- Masa disiplinore i bëhet e ditur me shkresë çdo institucioni privat ose publik nga i cili student i ka marrë bursë ose kredi,
- d- Masa disiplinore; nëse është e nevojshme mund t'i dërgohet në formë njoftimi institucionit ose degëve të tij.

Neni 32

Zbatimi

Nëse Këshilli i Etikës nuk përcakton një datë tjetër për hyrjen në fuqi të masës disiplinore, atëherë ajo hyn në fuqi në ditën e dhënies së saj.

Neni 33

Afatet e ankimimit dhe rruga e procedurës administrative

Masat disiplinore; vërejtje, paralajmërim me shkrim, pezullim i së drejtës për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Bedër” për një periudhë një javë deri në një muaj, pezullim i së drejtës për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Bedër” për një periudhë kohore një semestrale, nuk mund të anulohen nga asnjë organ administrativ më i

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	13 / 15	

lartë. Masat disiplinore të parashikuara në këtë Rregullore mund të ankimohen në rrugë administrative.

Masa disiplinore përjashtim nga Kolegji Universitar “Bedër” e dhënë nga Këshilli i Etikës mund të ankimohet në Rektorat brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

Në rast se ankimohet në Rektorat, ky i fundit mund të lërë në fuqi masën disiplinore ose ta anulojë atë.

Vendimi i marrë nga Rekorati, i bëhet i ditur studentit, i cili mund ta ankimojë në rrugë administrative.

Neni 34

Parashkrimi

Studentet të cilët janë autorë të veprimeve apo mosveprimeve të cilat përbëjnë shkelje disiplinore, do të ndëshkohen sipas masave të mëposhtme nga Këshilli i Etikës:

- a) Brenda një muaji për masat: vërejtje, paralajmërim me shkrim, largim nga Kolegji Universitar “Bedër” nga një javë deri në një muaj.
- b) Brenda gjashtë muajve për masat, largim nga Institucioni për një semestër dhe masën përjashtim nga Kolegji Universitar “Bedër”.

Në rast se nga data e fillimit të procedimit disiplinor deri në datën e përfundimit të tij kanë kaluar më shumë se dy vjet, nuk mund të jepet më masë disiplinore. Për shkaqe të arsyeshme Këshilli i Etikës mund të kërkojë një afat shtesë. Gjithsesi ai duhet të përfundojë procesin sa më shpejt dhe me efikasitet.

PJESA E PESTË

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

Njoftimi dhe adresa

a- Me qëllim ushtrimin e hetimit disiplinor, identiteti dhe adresa e çdo studenti pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit në Kolegjin Universitar “Bedër” ose në formën e njoftimit në institucion.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	RREGULLORJA E DISPLINËS SË STUDENTËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-006-AL	01.10.2012	0	0	14 / 15

b- Në rast se adresat ndryshojnë pas periudhës së regjistrimit në Kolegjin Universitar “Bedër” dhe studenti nuk informon institucionin, ose me qëllim jep një adresë të pasaktë, ato nuk mund të pretendojnë se nuk janë njoftuar, kur njoftimi është dërguar në adresën e dhënë prej tyre.

Neni 36

Dorëzimi i dosjes

Dosja e formuar gjatë procedimit disiplinor dhe çdo material që lidhet me të dorëzohen së bashku. Dorëzimi i dokumenteve firmoset si nga ai që i dorëzon si dhe nga ai që i merr në dorëzim.

Neni 37

Forma e korrespondencës

Shkresat që kanë të bëjnë me personat bëhen zakonisht në mënyrë formale. Çdo shkresë, firmoset dhe ruhet në dosje. Informacionet e marra sipas nenit 35 janë konfidenciale dhe mbi to zbatohen dispozitat e ligjit për informimin e publikut.

Neni 38

Ndalimet

Çdo fazë e procesit të hetimit është konfidenciale. Në rast moszbatimi të këtij rregulli dhe të procedurave administrative zbatohet Rregullorja e disiplinës për personelin akademik dhe administrativ në Kolegjin Universitar “Bedër”.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit në Senatin Akademik.

Neni 40

Zbatimi

Zbatimi i kësaj Rregulloreje sigurohet nga Rektori i institucionit.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Dekanati i Studentëve	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati